

TAKIMI I GRUPIT TË PUNËS TË EUROSA-IT “MBI PËRFITIMET DHE METODOLOGJITË E AUDITIMIT NË KOHË REALE”

Më 11 maj 2023, në Romë u organizua takimi i Grupit të Punës të EUROSA-it “Mbi përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale”. Ky aktivitet u organizua nga Gjykata Italiane e Audituesve.



Kriza ekonomike dhe financiare, pandemia dhe emergjencat që lidhen me ngjarjet e fundit të luftës kanë bërë që Institucionet Supreme të Auditimit të ndërgjegjësohen për nevojën e pashmangshme për t'u pajisur me mjete kontrolli të afta për të kombinuar saktësinë e kërkimeve me afate kohore gjithnjë e më të shkurtra duke parë shpejtësinë e ndryshimeve të kohëve të fundit.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga SAI-e si: Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Çekia, Gjermania, Hungaria, Shqipëria, Kosova, Lituania, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Turqia, Britania e Madhe dhe Italia si koordinatorë e këtij grupi pune.

Përfaqësues të SAI-t të Francës, Letonisë dhe Ukrainës e ndoqën online këtë takim. KLSH u përfaqësua nga znj. Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme dhe znj. Amantja Patozi, Përgjegjëse e Sektorit të Komunikimit dhe Botimeve.

SAI-t pjesëmarrëse ranë dakord për dobinë e një analize dhe qasje të njëjtë, si një rrugë që do të sjellë përdorimin e një gjuhe të përbashkët metodologjike për përmirësimin e sistemeve të kontrollit. Në takimin e ardhshme do të diskutohet zhvillimi i një metodologjie për këtë lloj auditimi dhe kryerja e një ankete për të përcaktuar situatën për përdorimin e auditimit në kohë reale.